

REPUBLIKA E SHQIPERISE  
GJYKATA E RREHIT GJYQESOR TIRANE  
Nr 38563

38563

V E N D I M

PER REGJISTRIM SI PERSON JURIDIK

Sot me date 15 / 6 / 2007, para meje gjyqtares se Rrethit Gjyqesor Tirane, Majlinda Dogga, u paraqit kerkesa per te regjistruar si person juridik shoqerine **SALI ELEKTRIK shpk.**

Pasi shqyrtova kerkesen:

K O N S T A T O V A

Kerkesen e paraqitur nga kerkuesi Bardhyl Sali, lindur me 13.09.1963, banues ne: Rr. "Komuna e Parisit" Pallati i Ri, Tirane, nenshtetas shqiptar, me numer pashaporte Z2051037, madhor dhe me zotesi te plote per te vepruar, ne cilesine e Administratorit, per te regjistruar si person juridik kete shoqeri .

Selia e shoqerise eshte ne qytetin e Tiranes. Selia e shoqerise eshte ne adresen: Kashar, Autostrada Tirane-Durres, kilometri 7.

Kohezgjatja e kesaj shoqerie eshte e papercaktuar.

Administrator i vetem i shoqerise eshte zoti BARDHYL SALI. Administratori emerohet me miratimin e ortakëve qe zoterojne mbi ½ e pjeseve te kapitalit themeltar. Ne rast te mungeses apo pamundesise se perkohshme ne ushtrimin e detyres, Administratori mund te emeroje perkohesisht si perfaqesues te tij, ne permbushjen e detyrave funksionale, njerin prej ortakëve te shoqerise.

Vlera e Kapitalit Themeltar eshte 200 000 Euro. Kapitali ndahet ne 1000 pjese te barabarta, secila me vlere prej 200 Euro, te renditura nga numri 1 deri ne numrin 1000, te nenshkruara dhe te shlyera plotesisht ne kete menyre:

Bardhyl Sali - zoteron 600 Kuota me vlere nominale 200 Euro secila, te cilat perfaqesojne 60% te kapitalit themeltar, te numeruara nga 1 ne 600.

Refat Sali – zoteron 400 Kuota me vlere nominale 200 Euro secila, te cilat perfaqesojne 40% te kapitalit themeltar, te numeruara nga 601 ne 1000.

Kapitali depozitohet sipas nenit 40 te Ligjit nr. 7638, date 19.11.1992 "Per shoqerite tregtare". Cdo pjese e kapitalit themeltar i jep te drejten e nje vote zoteruesit te saj. Ortaket e shoqerise perballojne humbjet e saj deri ne kufirin e vleres se kontributeve te tyre te derdhur ne formimin e kapitalit themeltar.

Shoqeria ka per objekt te veprimtarise se saj :

- a) Import-eksporti, shitja me shumice dhe pakice, dhenia dhe marrja me qira e materialeve dhe pajisjeve elektrike per instalime civile dhe industriale.
- b) Montimi i pajisjeve, projektimi dhe instalimi, venia ne zbatim e projekteve.
- b) Importimin dhe eksportimin e materialeve aksesore, si dhe te mallrave dhe materialeve te cdo lloji;
- d) Aktivitetet tregtare, duke perfshire, por duke mos u kufizuar tek shitja si dhe shitja me shumice e materialeve, pajisjeve, pjeseve aksesore, mallrave dhe materialeve elektrike dhe elektronike;
- e) Pjesemarrjen dhe organizimin e ekspozitave, panairove dhe/apo aktiviteve te ngjashme ne lidhje me objektin e veprimtarise se shoqerise;
- f) Investimet, duke perdorur fondet e institucioneve financiare vendase dhe te huaja;
- g) Cdo aktivitet tjetër, i lidhur ne menyre te drejteperdrejte apo qe ka lidhje me aktivitetet e siperpermendura, i cili konsiderohet fitimprures nga organet administruese te shoqerise;

Ne vijim, bazuar ne legjislacionin shqiptar, me qellim arritjen e objektivave te mesiperme, shoqeria mund:

- a) te kryeje cdo transakcion ne lidhje me pasurite e luajtshme apo ato te paluajtshme, si dhe cdo aktivitet tregtar dhe financiar, te vendose barra hipotekore dhe pengje; aktivite keto te konsideruara si te dobishme apo te nevojshme per te arritur qellimet e shoqerise dhe qe nuk tejkalojne ne mase aktivitetet kryesore, te cituara me siper;
- b) te kryeje aktivite publikimi dhe reklamimi.

Shoqeria kryen cdo lloj aktiviteti ne raport me objektin apo per te favorizuar ate. Asnje prej ortakeve te kesaj shoqerie, nuk mund te ushtroje te njejtin aktivitet tregtar me ate te shoqerise, duke e konkurruar brenda territorit te RSH-se, per nje periudhe 3 vjecare, duke filluar nga momenti i themelimit te shoqerise. I njejti parashikim vlen edhe ne rastet kur secili ortak shet kuotat qe zoteron ne shoqerine SALI ELEKTRIK shpk, perpara perfundimit te kesaj periudhem, me perjashtim te rastit kur te gjithe ortaket ju transferojne njekohesisht kuotat te treteve.

Pasi shqyrtova kerkesen, cmova se ajo eshte e drejte dhe e bazuar ne ligj.

### **PER KETO ARSYE**

Dhe ne baze nenit 22 te ligjit 7632, date 4.11.1992, "Per dispozitat qe rregullojne pjesen e pare te Kodit Tregtar", te ligjit 7638 date 19.11.1992 "Per shoqerite tregtare" dhe ligjit 7667 date 28.01.1993 "Per regjistrimin ne regjistrin tregtar".

### **VENDOSA:**

Regjistrimin e shoqerise me pergjegjesi te kufizuar **SALI ELEKTRIK shpk** si person juridik.

Selia e shoqerise eshte ne qytetin e Tiranes. Selia e shoqerise eshte ne adresen: Kashar, Autostrada Tirane-Durres, kilometri 7.

Kohezgjatja e kesaj shoqerie eshte e papercaktuar.

Administrator i vetem i shoqerise eshte zoti BARDHYL SALI. Administratori emerohet me miratimin e ortakeve qe zoterojne mbi ½ e pjeseve te kapitalit themeltar. Ne rast te mungeses apo pamundesise se perkohshme ne ushtrimin e detyres, Administratori mund te emeroje perkohesisht si perfaqesues te tij, ne permbushjen e detyrave funksionale, njerin prej ortakeve te shoqerise.

Vlera e Kapitalit Themeltar eshte 200 000 Euro. Kapitali ndahet ne 1000 pjese te barabarta, secila me vlere prej 200 Euro, te renditura nga numri 1 deri ne numrin 1000, te nenshkruara dhe te shlyera plotesisht ne kete menyre:

Bardhyl Sali - zoteron 600 Kuota me vlere nominale 200 Euro secila, te cilat perfaqesojne 60% te kapitalit themeltar, te numeruara nga 1 ne 600.

Refat Sali – zoteron 400 Kuota me vlere nominale 200 Euro secila, te cilat perfaqesojne 40% te kapitalit themeltar, te numeruara nga 601 ne 1000.

Kapitali depozitohet sipas nenit 40 te Ligjit nr. 7638, date 19.11.1992 “Per shoqerite tregtare”. Cdo pjese e kapitalit themeltar i jep te drejten e nje vote zoteruesit te saj. Ortaket e shoqerise perballojne humbjet e saj deri ne kufirin e vleres se kontributeve te tyre te derdhur ne formimin e kapitalit themeltar.

Shoqeria ka per objekt te veprimtarise se saj :

- a) Import-eksporti, shitja me shumice dhe pakice, dhenia dhe marrja me qira e materialeve dhe pajisjeve elektrike per instalime civile dhe industriale.
- b) Montimi i pajisjeve, projektimi dhe instalimi, venia ne zbatim e projekteve.
- b) Importimin dhe eksportimin e materialeve aksesore, si dhe te mallrave dhe materialeve te cdo lloji;
- d) Aktivitetet tregtare, duke perfshire, por duke mos u kufizuar tek shitja si dhe shitja me shumice e materialeve, pajisjeve, pjeseve aksesore, mallrave dhe materialeve elektrike dhe elektronike;
- e) Pjesemarrjen dhe organizimin e ekspozitave, panairove dhe/apo aktiviteteve te ngjashme ne lidhje me objektin e veprimtarise se shoqerise;
- f) Investimet, duke perdorur fondet e institucioneve financiare vendase dhe te huaja;
- g) Cdo aktivitet tjetër, i lidhur ne menyre te drejteperdrejte apo qe ka lidhje me aktivitetet e siperpermendura, i cili konsiderohet fitimprures nga organet administruese te shoqerise;

Ne vijim, bazuar ne legjislacionin shqiptar, me qellim arritjen e objektivave te mesiperme, shoqeria mund:

- a) te kryeje cdo transaksion ne lidhje me pasurite e luajtshme apo ato te paluajtshme, si dhe cdo aktivitet tregetar dhe financiar, te vendose barra hipotekore dhe pengje; aktivite keto te

konsideruara si te dobishme apo te nevojshme per te arritur qellimet e shoqerise dhe qe nuk tejkalojne ne mase aktivitetet kryesore, te cituara me siper;

b) te kryeje aktivitate publikimi dhe reklamimi.

Shoqeria kryen cdo lloj aktiviteti ne raport me objektin apo per te favorizuar ate. Asnje prej ortakëve te kesaj shoqerie, nuk mund te ushtroje te njejtin aktivitet tregtar me ate te shoqerise, duke e konkurruar brenda territorit te RSH-se, per nje periudhe 3 vjecare, duke filluar nga momenti i themelimit te shoqerise. I njejti parashikim vlen edhe ne rastet kur secili ortak shet kuotat qe zoteron ne shoqerine SALI ELEKTRIK shpk, perpara perfundimit te kesaj periudhem, me perjashtim te rastit kur te gjithë ortakët ju transferojne njekohesisht kuotat te treteve.

Kunder ketij vendimi lejohet ankim ne Gjykatën e Apelit.

  
**GJYKATARE**  
**Majlinda Dogga**



**Akt Themelimi**  
**"SALI ELEKTRIK" shpk**  
**Shoqeri Me Pergjegjesi Te Kufizuar**

Ne Tirane, sot me daten 08.06.2007 para meje Noteres Irena Laha, anetare e Dhomes se Notereve Tirane, u paraqiten personalisht shtetasit:

- **Bardhyl Sali**, i biri i Veipit, lindur me 13.09.1963, ne Vlore, banues ne: Rr. "Komuna e Parisit", Pallati i Ri, Tirane, shtetas shqiptar, mbajtes i pasaportes nr. Z2051037, madhor me zotesi te plote per te vepruar;
- **Refat Sali**, i biri i Veipit, lindur me 26.08.1959, ne Vlore, banues ne: Rr. "Komuna e Parisit", Pallati i Ri, Tirane, shtetas shqiptar, mbajtes i pasaportes nr. Z0012276, madhor me zotesi te plote per te vepruar;

**I. Themelimi**

Te cilet deklaruan themelimin e shoqerise me pergjegjesi te kufizuar "SALI ELEKTRIK" sh.p.k ("Shoqeria"), bazuar ne ligjin 7638 date 19.11.1992 "Per shoqerite tregtare". Ortaket rane dakort per te zhvilluar me vullnetin e tyre te lire veprimtari tregtare ne perputhje me legjislacionin shqiptar ne fuqi. Kohezgjatja e shoqerise eshte e pacaktuar.

**II. Selia**

Selia e shoqerise eshte ne qytetin e Tiranës ne adresen: Kashar, Autostrada Tirane-Durres, kilometri 7.



### III. Objekti

3.1. Shoqeria ka per objekt te veprimtarise se saj :

- a) Import-eksporti, shitja me shumice dhe pakice, dhenia dhe marrja me qera e materialeve dhe pajisjeve elektrike per instalime civile dhe industriale.
- b) Montimi i pajisjeve, projektimi dhe instalimi, venia ne zbatim e projekteve.
- b) Importimin dhe eksportimin e materialeve aksesore, si dhe te mallrave dhe materialeve te cdo lloji;
- d) Aktivitetet tregtare, duke perfshire, por duke mos u kufizuar tek shitja si dhe shitja me shumice e materialeve, pajisjeve, pjeseve aksesore, mallrave dhe materialeve elektrike dhe elektronike;
- e) Pjesemarrjen dhe organizimin e ekspozitave, panaireve dhe/apo aktiviteteve te ngjashme ne lidhje me objektin e veprimtarise se shoqerise;
- f) Investimet, duke perdorur fondet e institucioneve financiare vendase dhe te huaja;
- g) Cdo aktivitet tjeter, i lidhur ne menyre te drejteperdrejte apo qe ka lidhje me aktivitetet e siperpermendura, i cili konsiderohet fitimprures nga organet administruese te shoqerise;

3.2. Ne vijim, bazuar ne legjislacionin shqiptar, me qellim arritjen e objektivave te mesiperme, shoqeria mund:

- a) te kryeje cdo transakcion ne lidhje me pasurite e luajtshme apo ato te paluajtshme, si dhe cdo aktivitet tregtar dhe financiar, te vendose barra hipotekore dhe pengje; aktivite keto te konsideruara si te dobishme apo te nevojshme per te arritur qellimet e shoqerise dhe qe nuk tejkalojne ne mase aktivitetet kryesore, te cituara me siper;
- b) te kryeje aktivite publike dhe reklamimi.

3.3. Shoqeria kryen cdo lloj aktiviteti ne raport me objektin apo per te favorizuar ate. Asnje prej ortakeve te kesaj shoqerie, nuk mund te ushtroje te njejin aktivitet tregtar me ate te shoqerise, duke e konkurruar brenda territorit te RSH-se, per nje periudhe 3 vjecare, duke filluar nga momenti i themelimit te shoqerise. I njeiti parashikim vlen edhe ne rastet kur secili ortak shet kuotat qe zoteron ne shoqerine "SALI ELEKTRIK" shpk, perpara perfundimit te kesaj periudhe, me perjashtim te rastit kur te gjithë ortakët i transferojne njekohesisht kuotat te treteve.

#### IV. Statuti

Ortakët Themelues deklarojnë pajisjen e shoqërisë me statut, të firmosur prej tyre dhe të noterizuar. Statuti i aneksohet këtij akti.

#### V. Nenshkrimi i Kapitalit

Vlera e Kapitalit Themeltar është **200 000 Euro**. Kapitali ndahet në **1000 pjesë të barabarta**, secila me vlerë prej **200 Euro**, të renditura nga numri 1 deri në numrin 1000, të nënshkruara dhe të shlyera plotësisht në këtë mënyrë:

**Bardhyl Sali** - zoteron **600 Kuota**, me vlerë nominale **200 Euro** secila, të cilat përfaqësojnë **60%** të kapitalit themeltar, të numeruara nga 1 në 600.

**Refat Sali** – zoteron **400 Kuota** me vlerë nominale **200 Euro** secila, të cilat përfaqësojnë **40%** të kapitalit themeltar, të numeruara nga 601 në 1000.

Kapitali depozitohet sipas nenit 40 të Ligjit nr. 7638, datë 19.11.1992 "Për shoqëritë tregtare". Çdo pjesë e kapitalit themeltar i jep të drejtën e një vote zotëruesit të saj. Ortakët e shoqërisë përballojnë humbjet e saj deri në kufirin e vlerës së kontributeve të tyre të derdhur në formimin e kapitalit themeltar.

#### VI. Shlyerja e Kapitalit

Ortakët Themelues kanë depozituar shumën prej 200 000 Euro, në emër të "SALI ELEKTRIK" shpk në formim të siper. Certifikata që verteton këtë depozitim i aneksohet këtij akti.

"SALI ELEKTRIK" shpk disponon lirshmerisht këtë shumë pas regjistrimit në Regjistrin Tregtar.

#### VII. Administratori

Administratori i shoqërisë është Bardhyl Sali. Administratori emërohet me miratimin e ortakëve që zotërojnë mbi  $\frac{1}{2}$  e pjesëve të kapitalit themeltar. Në rast të mungesës apo pamundësisë së



perkohshme ne ushtrimin e detyres, Administratori mund te emeruje perkohesisht si perfaqesues te tij, ne permbytjen e detyrave funksionale, njerin prej ortakeve te shoqerise.

Me daten 08/06 / 2007, ne Tirane, u hartua dhe u nenshkrua, me vullnetin e lire te ortakeve themelues, ky Akt Themelimi i Shoqerise "SALI SLEKTRIK" sh.p.k., ne 5 kopje ne gjuhen shqipe, me vlere te njejte ligjore.

PER SHOQERINE  
"SALI ELEKTRIK" SHPK

ORTAKET

BARDHYL SALI

Bardhyl Sali  
dali


REFAT SALI

Refat Sali

NOTERE

IRENA LAHA

Irena Laha





**STATUTI I SHOQERISE  
ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR  
"SALI ELEKTRIK" SHPK**

**I. KRIJIMI , FORMA , EMERTIMI, SELIA, KOHEZGJATJA DHE OBJEKTI I**

**SHOQERISE**

**Neni 1**

**Emertimi**

1.1. Emertimi tregtar i shoqerise eshte **SALI ELEKTRIK shpk.**

1.2. **SALI ELEKTRIK shpk** eshte nje shoqeri me pergjegjesi te kufizuar. Aktiviteti i kesaj shoqerie rregullohet nga ky statut dhe nga Ligji nr. 7638, date 19.11.1992, "Per shoqerite tregtare".

**Neni 2**

**Selia**

2.1. Selia e shoqerise eshte ne qytetin e Tiranes ne adresen: Kashar, Autostrada Tirane-Durres, kilometri 7.

2.2. Ajo mund te hapi dege dhe / ose filiale ne te gjitha rrethet e vendit si edhe jashte tij.

**Neni 3**

**Vula**

3.1. Shoqeria ka vulen e saj mbi te cilen ka te shkruar emertimin e saj tregtar.



#### Neni 4 Kohezgjatja

4.1. Kohezgjatja e shoqerise eshte e pacaktuar.

#### Neni 5 Objekti

5.1. Shoqeria ka per objekt te veprimtarise se saj :

- a) Import-eksporti, shitja me shumice dhe pakice, dhenia dhe marrja me qira e materialeve dhe pajisjeve elektrike per instalime civile dhe industriale.
- b) Montimi i pajisjeve, projektimi dhe instalimi, venia ne zbatim e projekteve.
- b) Importimin dhe eksportimin e materialeve aksesore, si dhe te mallrave dhe materialeve te cdo lloji;
- d) Aktivitetet tregtare, duke perfshire, por duke mos u kufizuar tek shitja si dhe shitja me shumice e materialeve, pajisjeve, pjeseve aksesore, mallrave dhe materialeve elektrike dhe elektronike;
- e) Pjesemarrjen dhe organizimin e ekspozitave, panairove dhe/apo aktiviteteve te ngjashme ne lidhje me objektin e veprimtarise se shoqerise;
- f) Investimet, duke perdorur fondet e institucioneve financiare vendase dhe te huaja;
- g) Cdo aktivitet tjeter, i lidhur ne menyre te drejteperdrejte apo qe ka lidhje me aktivitetet e siperpermendura, i cili konsiderohet fitimprures nga organet administruese te shoqerise;

5.2. Ne vijim, bazuar ne legjislacionin shqiptar, me qellim arritjen e objektivave te mesiperme, shoqeria mund:

a) te kryeje cdo transaksion ne lidhje me pasurite e luajtshme apo ato te paluajtshme, si dhe cdo aktivitet tregetar dhe financiar, te vendose barra hipotekore dhe pengje; aktivite keto te konsideruara si te dobishme apo te nevojshme per te arritur qellimet e shoqerise dhe qe nuk tejkalojne ne mase aktivitetet kryesore, te cituara me siper;

b) te kryeje aktivite publikimi dhe reklamimi.

5.3. Shoqeria kryen cdo lloj aktiviteti ne raport me objektin apo per te favorizuar ate. Asnje prej ortakeve te kesaj shoqerie, nuk mund te ushtroje te njejtin aktivitet tregtar me ate te shoqerise, duke e konkurruar brenda territorit te RSH-se, per nje periudhe 3 vjecare, duke filluar nga momenti i themelimit te shoqerise. I njejtj parashikim vlen edhe ne rastet kur secili ortak shet kuotat qe zoteron ne shoqerine SALI ELEKTRIK shpk, perpara perfundimit te kesaj periudhem, me perjashtim te rastit kur te gjithë ortakët ju transferojne njekohesisht kuotat te treteve.

## **II. ORTAKET, KAPITALI THEMELTAR, KONTRIBUTET, PJESET E KAPITALIT** **THEMELTAR**

### **Neni 6**

#### **Ortakët**

6.1. Ortakët e shoqerise SALI ELEKTRIK shpk jane :

- **Bardhyl Sali**, i biri i Veipit, lindur me 13.09.1963, ne Vlore, banues ne: Rr. "Komuna e Parisit", Pallati i Ri, Tirane, shtetas shqiptar, mbajtes i pasaportes nr. Z2051037, madhor me zotesi te plote per te vepruar;

- **Refat Sali**, i biri i Veipit, lindur me 26.08.1959, ne Vlore, banues ne: Rr. "Komuna e Parisit", Pallati i Ri, Tirane, shtetas shqiptar, mbajtes i pasaportes nr. Z0012276, madhor me zotesi te plote per te vepruar;

6.2. Ortakët rane dakort per te zhvilluar me vullnetin e tyre te lire veprimtari tregtare ne perputhje me legjislacionin shqiptar ne fuqi.

### **Neni 7**

#### **Kapitali themeltar**

7.1. Vlera e Kapitalit Themeltar eshte 200 000 Euro.



7.2. Kapitali ndahet ne 1000 pjese te barabarta, secila me vlere prej 200 Euro, te venditura nga numri 1 deri ne numrin 1000, te nenshkruara dhe te shlyera plotesisht ne kete menyre:

**Bardhyl Sali** - zoteron **600 Kuota** me vlere nominale **200 Euro** secila, te cilat perfaqesojne **60%** te kapitalit themeltar, te numeruara nga 1 ne 600.

**Refat Sali** - zoteron **400 Kuota** me vlere nominale **200 Euro** secila, te cilat perfaqesojne **40%** te kapitalit themeltar, te numeruara nga 601 ne 1000.

7.3. Kapitali depozitohet sipas nenit 40 te Ligjit nr. 7638, date 19.11.1992 "Per shoqerite tregtare".

7.4. Pjeset nuk materializohen ne letra me vlere te tregtueshme por vertetohen me ane te certifikatave nominative te leshuara nga shoqeria.

7.5. Cdo pjese e kapitalit themeltar i jep te drejten e nje vote zoteruesit te saj.



7.6. Ortaket e shoqerise perballojne humbjet e saj deri ne kufirin e vleres se kontributeve te tyre te derdhur ne formimin e kapitalit themeltar.

## **Neni 8** **Transferimi**

8.1. Pjeset e kapitalit transferohen lirisht midis ortakeve.

8.2. Transferimi i pjeseve te kapitalit tek persona te trete dhe / ose transferimi i pjeseve ne rruge trashegimie, si dhe transferimi tek persona te trete qe nuk bejne pjese ne shoqeri iu nenshtrohet ketyre rregullave:

a. Transferuesi apo trashaguesi ne rastin e transferimit ne rruge trashegimie, duhet t'i njoftoje shoqerise numrin e pjeseve qe do te transferohen, çmimin e shitjes ne rast shitjeje, si dhe emrin, mbriemrin dhe adresen e personit te cilit i transferohen pjeset.



b. Transferimi duhet te miratohet nga Asambleja e ortakeve brenda tre muajve nga dita e njoftimit. Ne rast se shoqeria nuk ka bere te ditur vendimin e saj brenda afatit tre mujor, miratimi qohet i dhene.

c. Asambleja miraton transferimin vetem me shumicen e ortakeve qe perfaqesojne te pakten  $\frac{3}{4}$  (tre te katertat) e pjeseve te kapitalit themeltar.

d. Ne rast se shoqeria refuzon transferimin, brenda tre muajve nga data e refuzimit, ortaket duhet t'i blejne pjeset e propozuara per transferim. Cmimi i shitjes eshte vlera kontabel e pjeseve (book value). Nese disa ortake jane te interesuar njeheresh ne blerjen e pjeseve, e drejta e tyre eshte proporcionale me numrin e pjeseve qe ata zoterojne. Ne rast se asnje ortak nuk eshte i interesuar te bleje pjeset, atehere Asambleja duhet te vendose, me shumicen e ortakeve qe perfaqesojne te pakten  $\frac{3}{4}$  (tre te katertat) e pjeseve te kapitalit themeltar, nese: 1. pjeset do t'i shiten personit te propozuar nga transferuesi me çmimin e rene dakort midis tyre; 2. pjeset do t'i shiten nje personi tjetër te trete me çmimin e rene dakort me kete person por jo me pak se vlera kontabel e tyre.


8.3. Transferimi i pjeseve te kapitalit themeltar, ne çdo rast, duhet te vertetohet me akt noterial.

## Neni 9 Zmadhimi

9.1. Kapitali themeltar mund te zmadhohet me vendim te ortakeve qe perfaqesojne te pakten  $\frac{3}{4}$  (tre te katertat) e pjeseve te kapitalit themeltar, ne perputhje me nenet 62 dhe 63 te Ligjit nr. 7638, date 19.11.1992 "Per shoqerite tregtare".

9.2. Zmadhimi i kapitalit mund te kryhet me ane te kontributeve te reja ne para, me ane te kontributeve ne natyre ose me perfshirjen e rezervave dhe fitimit.

9.2. Ortaket kane te drejten e rritjes ne menyre proporcionale (ne te njejten mase me pjeset e kapitalit qe ata perfaqesojne). Askush nuk mund te favorizohet apo te defavorizohet nepermjet zmadhimit te kapitalit (parimi i trajtimit te barabarte).



9.3. Megjithate, ne asnje rast, ortaket qe perfaqesojne te pakten  $\frac{3}{4}$  (tre te katertat) e pjeseve te kapitalit themeltar, nuk mund te detyrojne nje apo disa ortaket te minorances per te rritur angazhimin e tyre ne kapitalin themeltar te shoqerise. Ne kete rast, kapitali rritet ne menyre proporcionale ndermjet ortakëve qe kane pranuar zmadhimin e tij.

9.4. Ne rast zmadhimi te kapitalit me ane te kontributeve ne para, te gjitha pjeset e reja duhet te nenshkruhen dhe shlyhen teresisht. Ato duhet te depozitohen nga nenshkruesit per llogari te shoqerise. Terheqja e fondeve te reja mund te behet vetem pas regjistrimit te zmadhimit te kapitalit ne Regjistrin Tregtar. Ne rast se zmadhimi i kapitalit nuk regjistrohet ne regjistrin tregtar brenda gjashte muajsh qe nga data e depozitimit te pare te fondeve, kontribuesit kane te drejte individualisht ose bashkarisht, te kerkojne ne rruge gjyqesore autorizim per terheqjen e shumes se kontributeve te tyre.


#### Neni 10

#### Zvoglimi

10.1. Zvoglimi i kapitalit deri ne nje vlere jo me te vogel se 100 000 Leke mund te kryhet me vendim te ortakëve qe perfaqesojne te pakten  $\frac{3}{4}$  (tre te katertat) e pjeseve te kapitalit themeltar, ne perputhje me nenin 64, Ligji nr. 7638, date 19.11.1992, "Per shoqerite tregtare".

10.2. Zvoglimi i prek ortaket ne te njejten mase ndaj pjeseve te kapitalit qe ata perfaqesojne.

10.3. Ne rast se kapitali i shoqerise, per shkak te humbjeve te konstatuara ne dokumentat financiare, rezulton me i vogel se gjysma e kapitalit themeltar, brenda kater muajve nga miratimi i llogarive qe pasqyrojne keto humbje, ortaket qe perfaqesojne te pakten  $\frac{3}{4}$  (tre te katertat) e pjeseve te kapitalit themeltar, duhet te vendosin ose prishjen e shoqerise, ose zvoglimin e kapitalit me nje vlere me te madhe se ajo e humbjeve qe kane mbetur te pambuluara nga rezervat, por pa e zbritur kapitalin nen shumen 100 000 Leke, ne perputhje me nenet 72 dhe 38, Ligji nr. 7638, date 19.11.1992, "Per shoqerite tregtare".



### III. MARRJA E VENDIMEVE, ADMINISTRIMI, DHE KONTROLLI I SHOQERISE



#### **Neni 11 Asambleja e Ortakeve**

11.1. Vendimet merren nga asambleja e ortakeve.

11.2. Çdo ortak ka te drejte te marre pjese ne mbledhjet dhe ne vendimet e asamblese dhe disponon nje numer votash te barabarte me pjeset e kapitalit themeltar qe ai zoteron. Çdo ortak ka te drejte te perfaqesohet ne keto mbledhje nga nje ortak tjetër ose nga nje mandatmbajtës i cili mund te votoje ne emer te atij qe perfaqeson.

11.3. Asambleja mbledhet ne menyre te rregullt, çdo vit, brenda nje afati prej 6 muajsh nga dita e mbylljes se vitit financiar. Asambleja mund te thirret ne çdo kohe me kerkesen e: a. nje apo disa ortakeve qe perfaqesojne 10% te pjeseve te kapitalit themeltar, b. ekspertit kontabel te autorizuar, c. te administratorit, d. te likujduesit.

11.4. Administratori iu njofton te gjithë ortakeve, Mbledhjen e Asamblese, me leter rekomande, te pakten 15 dite perpara mbledhjes. Lajmerimi permban daten, adresen dhe rendin e dites se Mbledhjes. Cdo ortak mund te anulloje mbledhjen e asamblese se thirrur ne menyre te parregullt. Megjithate, nuk mund te anulohen mbledhjet e thirrura ne menyre te parregullt, nese te gjithë ortakët kane qene te pranishem apo te perfaqesuar.

11.5. Asambleja mund te marre vendime edhe me ane te konsultimit me shkrim te ortakeve. Konsultimi me shkrim kryhet ne kete menyre: a. Administratori harton nje propozim me shkrim te vendimit qe kerkohet te aprovohet; b. Administratori iu dergon te gjithë ortakeve propozimin me shkrim te vendimit me ane te nje letre rekomande, poste te regjistruar ose faxi; c. Ortaket kthejne nje pergjigje ekzakte nese miratojne apo refuzojne propozimin e vendimit, me ane te nje letre rekomande, poste te regjistruar ose faxi; d. Administratori mbledh miratimet dhe refuzimet dhe iu dergon te gjithë ortakeve rezultatin e votimit, me ane te nje letre rekomande, poste te regjistruar ose faxi; e. cdo ortak ka te drejte t'i kerkoje Administratorit te kontrolloje procesin e konsultimit me shkrim.



11.6. Asambleja drejtohet nga Kryetari i Asamblese ose ne mungese te tij, nga Administratori Kryetari i Asamblese emerohet dhe ndryshohet nga Asambleja me shumice te zakonshme. Ai nuk eshte punemarres i shoqerise. Kompetencat, te drejatat dhe detyrimet e tij ndaj shoqerise rregullohen ne aktin e emerimit.


11.7. Kryetari i asamblese emerone nje person fizik, ortak ose jo, ne postin e sekretarit. Sekretari mban proces - verbalin e mbledhjes, i cili firmoset nga te gjithet ortaket e pranishem ne mbledhje.

11.8. Votimi eshte ne parim i hapur. Me kerkese te nje ose disa ortakeve qe perfaqesojne me shume se gjysmen e pjeseve te kapitalit, votimi eshte sekret.

11.9. Jane ne kompetencen e Asamblese dhe nuk mund t'i delegohen Administratorit, marrja e vendimeve per sa i perket:

- a. ndryshimi i statutit
- b. riorganizimi i shoqerise, ndarja, bashkimi, likuidimi, shnderrimi
- c. zmadhimi, zvoglimi i kapitalit
- d. miratimi i llogarive, raporti vjetor, inventaret, raporti i eksperteve kontabel te autorizuar e emerimi dhe shkarkimi i Kryetarit te Asamblese
- f. emerimi dhe shkarkimi i Administratorit
- g. emerimi dhe shkarkimi i eksperteve kontabel te autorizuar
- h. te gjitha kompetencat e tjera qe ligji dhe / ose ky statut i japin shprehimisht Asamblese.

11.10. Asambleja merr vendim me shumice te zakonshme ose shumice te jashtezakonshme. Ne rast se shumica e zakonshme eshte e kerkuar, vendimet merren, ne Mbledhjen e pare, nga nje ose disa ortake qe perfaqesojne me shume se gjysmen e pjeseve te kapitalit. Ne rast se ky quorum nuk arrihet, ne Mbledhjen e dyte, vendimet merren me shumicen e votave prezente, pavaresisht nga perqindja e kapitalit qe ato perfaqesojne. Ne rast se shumica e jashtezakonshme eshte e kerkuar, vendimet merren, ne cdo rast dhe cdo here, nga ortaket qe perfaqesojne te pakten tre te katertat e pjeseve te kapitalit themeltar.



11.11. Asambleja vendos me shumice te jashtezakonshme:

- a. ndryshimin e statutit
- b. transferimin e pjeseve te kapitalit themeltar tek nje i trete
- c. zmadhimin apo zvoglimin e kapitalit themeltar
- d. prishjen e shoqerise ne rast se humbjet jane me te medha se gjysma e kapitalit
- e. shnderrimin e shoqerise ne shoqeri anonime

11.12. Per cdo ceshtje tjeter, Asambleja vendos me shumice te zakonshme.

11.13. Te gjitha vendimet e shoqerise regjistrohen ne nje liber te vecante, qe mbahet ne seline e shoqerise.


## **Neni 12** **Administratori**

12.1. Shoqeria administrohet nga Administratori, nje person fizik qe mund te jete ose jo ortak i shoqerise. Asambleja, me shumice te zakonshme, mund te vendose qe shoqeria te kete me shume se nje administrator. Ne kete rast, marredheniet midis administratoreve, kompetencat, te drejttat dhe detyrimet e secilit rregullohen ne Rregullore dhe / ose ne statut.

12.2. Administratori i shoqerise eshte Bardhyl Sali. Administratori emerohet me miratimin e ortakeve qe zoterojne mbi  $\frac{1}{2}$  e pjeseve te kapitalit themeltar. Ne rast te mungeses apo pamundesise se perkohshme ne ushtrimin e detyres, Administratori mund te emeroje perkohesisht si perfaqesues te tij, ne permbushjen e detyrave funksionale, njerin prej ortakeve te shoqerise.

12.3. Kohezgjatja e mandatit te Administratorit eshte e pacaktuar. Ai shkarkohet, me vendim te ortakeve qe perfaqesojne me teper se  $\frac{1}{2}$  e pjeseve te kapitalit themeltar.

12.4. Administratori ka te gjitha kompetencat per te kryer te gjitha veprimet ne emer dhe per interes te shoqerise, me perjashtim te atyre rasteve (kompetencave) qe ligji dhe / ose ky statut i japin shprehimisht Asamblese.



12.5. Administratori është përgjegjës individualisht ndaj shoqërisë apo të tretëve për shkelje ligjore, për shkelje të statutit apo për fajet e tyre gjatë administrimit të shoqërisë.

### **Neni 13**

#### **Eksperti kontabel i autorizuar**

13.1. Kontrolli i shoqërisë kryhet nga një ekspert kontabel i autorizuar (person fizik apo shoqëri). Ai caktohet me vendim të asamblesë, me shumicë të zakonshme.

## **IV. VITI FINANCIAR, LLOGARITE VJETORE, NDARJA E FITIMIT**

### **Neni 14**

#### **Viti financiar**

Çdo vit financiar fillon më 1 janar dhe përfundon në 31 dhjetor. Përkrahimisht viti i parë fillon në ditën e regjistrimit dhe përfundon në fund.

### **Neni 15**

#### **Llogarite vjetore**



15.1. Llogarite vjetore, inventari, raporte mbi operacionet e veprimtarisë së vitit financiar dhe raportet e veçuara të hartuara nga administratori dhe eventualisht nga eksperti kontabel i autorizuar, miratohen nga asambleja me shumicën e zakonshme.

15.2. Miratimi i dokumentave mbi veprimtarinë vjetore të shoqërisë bëhet brenda një afati prej 6 muajsh nga dita e mbylljes së vitit financiar.

### **Neni 16**

#### **Fitimi**

16.1. Fitimi neto i realizuar nga shoqëria, mbasi zbriten të gjitha shpenzimet, si edhe fondet e lena reserve për nxitje ekonomike, për investime për reklame tregtare etj.,



ndahen ndërmjet ortakëve në përputhje me përqindjen e kapitalit themelues që ka secili ortak.

16.2. Ortaku i huaj, fitimet e realizuara nga veprimtaria e shoqërisë, sipas përqindjes që i takon, mund të transferojë jashtë shtetit, në përputhje me dispozitat ligjore shqiptare në fuqi.

#### **Neni 17 Bilanci**

Bilanci vjetor i shoqërisë nxirret brenda 31 marsit të vitit pasardhës.

### **V. PRISHJA E SHOQËRISË DHE LIKUIDIMI**

#### **Neni 18 Likuidimi**


18.1. Shoqëria priset me vendim të asamblesë me shumicë të jashtëzakonshme dhe në përputhje me ligjet në Republikën e Shqipërisë.

18.2. Në rastin e prishjes së kompanisë, ajo kryen procesin e likuidimit në përputhje me ligjet në fuqi të Republikës së Shqipërisë.

### **VI. DISPOZITAT E FUNDIT**

#### **Neni 19 Mosmarreveshjet**

Për të gjitha mosmarreveshjet brenda shoqërisë që mund të lindin gjatë veprimtarisë së shoqërisë dhe që nuk mund të zgjidhen me mirëkuptim, organi kompetent për shqyrtimin e tyre është Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë.



Me daten 08/06/ 2007, ne Tirane, u hartua dhe u nenshkrua, me vullnetin e lire te ortakeve, ky statut ne 5 kopje ne gjuhen shqipe me vlere te njejte ligjore.



**PER SHOQERINE  
SALI ELEKTRIK SH.P.K.**

**ORTAKET**

**BARDHYL SALI**

*Bardhyl Sali*  
*Lili Smell*

**REFAT SALI**

*Refat Sali*  
*[Signature]*

38563

Z: M. Dajpa  
dt. 12. 06. 2007

12 GIU. 2007

KERKESE

Per

Regjistrimin si person juridik te shoqerise

SALI ELEKTRIK shpk



Kerkuesi:

Bardhyl Sali, lindur me 13.09.1963, banues ne: Rr. "Komuna e Parisit" Pallati i Ri, Tirane, nenshtetas shqiptar, me numer pashaporte Z2051037, madhor dhe me zotesi te plote per te pruar, ne cilesine e Administratorit te shoqerise.

Me objekt

Regjistrimin si person juridik te shoqerise me pergjegjesi te kufizuar **SALI ELEKTRIK shpk**

Baza ligjore

Ligji 7632, date 4.11.1992, "Per dispozitat qe rregullojne pjesen e pare te Kodit Tregtar", ligji 7638 date 19.11.1992 "Per shoqerite tregtare" dhe ligji 7667 date 28.01.1993 "Per regjistrimin ne regjistrin tregtar".

PERPARA GJYKATES SE RRETHIT GJYQESOR

TIRANE

Kerkuesi, Bardhyl Sali ne cilesine e Administratorit te shoqerise SALI LEKETRIK shpk paraqet kerkesen e tij perpara Gjykates se Rrethit Tirane per te regjistruar si person juridik kete shoqeri.

Selia e shoqerise eshte ne qytetin e Tiranës. Selia e shoqerise eshte ne adresen: Kashar, Autostrada Tirane-Durres, kilometri 7.

Kohezgjatja e kesaj shoqerise eshte e papercaktuar

*[Handwritten signature]*

*[Handwritten notes in the left margin:]*  
Kerkuesi: Bardhyl Sali  
Me objekt: Regjistrimi i kompanise  
Baza ligjore: Ligji 7632, 7638, 7667  
dt. 4.11.1992, 19.11.1992, 28.01.1993  
15/6/2007